

Edhe sa do që ministri të japë dorëheqjen

[Gazeta Shqiptare, 17.3.2006]

U bënë së paku tri gafa me radhë, që po bën ministri ynë i jashtëm, z. Mustafaj. Nuk ka asnjë shenjë autokritike, e jo më dorëheqjeje. Përkundrazi, ai po demonstroi një narcisizëm ekstrem, që nga justifikimet me shtrembërimin e shqipes, me përdorimin e tepruar të përemrit “unë”, e deri tek autolëvdatat pafund, si: “tash 15 vjet, askush nuk ka punuar në MJ, kaq mirë sa unë”. Për ta shkarkuar, nuk shkarkohet, sepse duket nuk është gjë tjetër veçse një megafon besnik i kryeministrit aktual.

Sjellja e një ministri, sidomos atij të MJ, mund të jetë shumë e dëmshme për secilin prej nesh shqiptarëve, qoftë brenda e qoftë jashtë kufinjve. Ai është më i rrezikshëm pikërisht kur bën sikur na përqafoi, me ato përqafoimet e ariut—“ta bashkojmë Kosovën me Shqipërinë”. Ky lloj përqafoimi, aktualisht është fare mbytyës, sado i ëmbël t’i duket ndonjë qarku ekstremist jashtë kufijve tanë. Bile, kjo e fundit është përtej gafës, sepse shkon kundër interesave të zgjidhjes së çështjes sonë kombëtare, që është vënë në vijë për t’u rregulluar, po ka shumë pengesa e do punë serioze për t’u arritur—nejse, për eufemizëm po i quajmë të gjitha thjeshtë gafa.

Tri gafat

E para, është pranimi si zëvendësministre, e asaj zonjës antiamerikane që nuk u pat miratuar për ambasadore në SHBA. Nuk duam të ripërsëritim shpjegimet që i kemi dhënë, se si mund të shkruash shpifje, jo vetëm kundër SHBA, por edhe kundër Muhamedit dhe Krishtit, “vetëm” duke “citur shtypin e kohës”, gjë që e pranoi publikisht se e ka bërë ajo zonja. Po e rikujtojmë, për të thënë se ky ministër kishte “fakte” të mjaftueshme që të mos e pranonte atë zonjë, sado të insistonte kryeministri aktual. Është kryeministri, -mund të thotë ndokush,-e nuk ka si e kundërshton ministri. Jo, ministri ka përgjegjësi personale për veprimet e mosveprimet që bën, dhe nuk mbrohet dot me “më urdhëroi Ai”, sepse fundja ka një armë të papërballueshme: jep dorëheqjen.

Gafa e dytë, është deklarata për “pavarsinë e kushtëzuar” të Kosovës. U bë kjo, kur edhe armiqet e kombit shqiptar, tashmë po e pranonin pavarësinë e Kosovës, si fakt të pakundërshtueshëm më. Natyrisht, që ministri u justifikua me sofizmat e “kushteve që duhet të plotësojë Kosova”, por këto nuk pijnë ujë, se çdo njeri e di që çdo shtet mbi tokë ka kushte në pavarësinë e tij. Kanë kushte edhe shtete si Iraku i Sadam Hysenit, që quhesh një fuqi e madhe ushtarake, dihet se ku i përfundoi “pavarësia”, meqë prishi kushtet—por kurrë, as ministri i jashtëm i Irakut, nuk tha se kemi pavarësi të kushtëzuar. Po kështu edhe Serbia e Millosheviçit, në momentin që prishi kushtet, dihet se ku i shkoi pavarësia—por as ata kurrë nuk thanë se kishin pavarësi të kushtëzuar. Përse ministri ynë theksonte “kushtet” për Kosovën?! Thuhet se bënte një lojë të stërholluar antiamerikane, por kjo është shumë e stërholluar, prandaj del jashtë temës së këtij shkrimi. Natyrisht që kryeministri ishte në unison, edhe me këtë gafën e dytë.

E treta, është kjo deklarata e tanishme e “mosgarantimit të kufijve” nëse Kosova del e pavarur. Qeshjet e fryrjet para kamerave, nuk e shlyejnë dot skandalin ndërkombetar: reagan menjëherë kundra, qendrat e diplomacisë perëndimore e ballkanike. Reagan edhe personalitete shqiptare, që ministri i përbuzi me një sjellje prej një njeriu të pagdhundur—e ishin ish kolegë të tij, si edhe shumë dashamirës të çështjes shqiptare, si nga brenda e si nga jashtë kufinjve të Republikës së Shqipërisë. Natyrisht, edhe këtu ka mendime se nxjerr krye prapë antiamerikanizmi i tij: amerikanët janë të interesuar për stabilitet në Ballkan, ku pjesë e këtij stabiliteti janë mosndryshimi i kufinjve të shteteve të pavarur, që nuk kanë asnjë faj në pislleqet e

Milloseviçit me shokë. Të tilla shtete janë në radhë të parë vetë Shqipëria, Maqedonia, Bullgaria, Rumania, Sllovenia, Bosnje-Hercegovina e Kroacia, kufinj të cilave duhen garantuar nga të gjithë ne, përfshirë edhe nga ministrin ynë. Ne po “garantojmë” në Bosnje-Herzegovinë, në Afganistan e në Irak, me ushtarët tanë, e jo nuk garantokemi në Ballkan! Ne jse, të shohim si do të reagojë kryeministri ynë aktual, për këtë gafën e tretë të ministrit të tij: do ta shesë, apo do ta mbajë!

Ministri mburravec ankohet se ”nuk po e kuptokan të gjithë”: ky është faji i tij, prandaj duhet një tjetër që e kuptojnë të gjithë, e që di të jetë kryesisht ministër, e shumë pak çdo lloj gjëje tjetër.

Bashkim Kopliku

Durrës, më 16.3.2006